



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 13.04.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 të Rregullores për Prokurim Publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **07.04.2023**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik "PHARMA LEADER" L.L.C. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me produkte specifike dhe insulina analoge nga Lista Esenciale" – Lot 1 dhe 2 me numër prokurimi: 206-23-1646-1-1-1 nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomik "PHARMA LEADER" L.L.C. e dt. 07.04.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me produkte specifike dhe insulina analoge nga Lista Esenciale" Lot 1 dhe Lot 2, me numër prokurimi: 206-23-1646-1-1-1, kundër Njoftimit për Kontratë të datës 03.03.2023 të publikuar në platformën elektronike.
2. **Mbetet në fuqi** vlera e parashikuar në dosje të tenderit, në lidhje me Lot 1 dhe Lot 2;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit;
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "PHARMA LEADER" L.L.C. me datë 07.04.2023 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me produkte specifike dhe insulina analoge nga Lista Esenciale" Lot 1 dhe Lot 2, me numër prokurimi: 206-23-1646-1-1-1. Autoriteti Kontraktues, me datë 13.04.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues sipas OE:

Neni 7 Barazia në trajtim - jo diskriminim
Neni 8 Planifikimi i Prokurimit
Neni 9 Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur

Neni 16 Llogaritja e Vlerës së Parashikuar të Kontratës për Furnizim
Neni 24 Zyrtarët e Prokurimit gjatë Ushtrimit të aktiviteteve të prokurimit
Neni 27 Dosja e Tenderit
Neni 28 Specifikimet teknike
Neni 51 Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes
Neni 69 Aftësia Teknike dhe ose Profesionale
Neni 70 Standardet për Sigurimin e Cilësisë

Pretendimi ankimor

Te nderuar, bazuar ne dispozitat e nenit 108/A, te LPP-se paraqesim kundërshtimin tone kundër procedurës se prokurimit, konkretisht kundër kritereve te kualifikimit dhe përcaktimit te vlerës se parashikuar.

Pretendimi ankimor.

Kompania jone me qellim te mos prolongimit edhe aplikimit te drejte te dispozitave ligjore; për këtë procedurë te prokurimit, ka kërkuar sqarim, pikërisht për loteti 1 dhe 2, ku ju si AK, keni zbritur vlerën e parashikuar për këto dy lote.

- Ne kontratat paraprake, sa i përket lot 1, "Interferon beta 1 a 22 mcg", vlera e përcaktuar për njësi ka qene **48.22 €**.
- Pikërisht për këtë lot, dhe për këtë produkt ne procedurën e tanishme, keni përcaktuar vlerën për njësi prej **43,57 €**.

Ndërsa për lotin 2, "Interferon beta 1a 44 mcg", ne kontratat paraprake vlera e parashikuar, për çmim njesie ka qene **56.08€**, ndersa ne këtë procedurë te prokurimit, keni zbritur ne vlerën prej: **55 €**.

Sipas përgjigjes suaj për këtë qeshje, ju si AK, potenconi se për këto dy lote çmimet janë përcaktuar nga komisioni për hulumtimin e tregut, ku tregues matës janë marre çmimet e importit ku është përcaktuar çmimi "tavan" për këto produkte dhe është çmim i saktë dhe objektiv.

Nuk ekziston baze ligjore për përcaktim te çmimit tavan te produkteve medicionale, ekziston projekt ligj i cili ende nuk ka hy ne fuqi, dhe ju si AK, nuk keni kurrfarë baze ligjore apo te drejte ti përcaktoni çmimet "tavan" e aq me pak vetëm për produkte te caktuara, përkatësisht vetëm për lote te caktuara siq është rasti me Lot 1 dhe Lot 2.

Komisioni per hulumtimin e tregut është i obliguar qe çmimet ti përcaktoj ne baze te mesatares se çmimeve referente te shteteve te rajonit, kontratave paraprak dhe vlerës se planifikuar te përcaktuar dhe te publikuar sipas planifikimit te prokurimit për vitin 2023.

1.1- Ju si AK, keni kërkuar çmimet referente, përkatësisht, Shqipëria çmimin referent për lot 1, e ka 55.52 €, Maqedonia e Veriut, 59.44 € ne Republika e Kosovës, çmimi referent ne kontratat paraprake ka qenë me i ulti ne rajon 48.22 €, ndërsa tani për shkak të inflacionit dhe rritjes së çmimeve ne nivel global në vend se të jet e kundërta e çmimet te nivelizohen me ato te rajoni ju e ulni çmimin në 43.57 € per njësi gjë që e bënë të pamundur furnizimin me këto produkte.

1.2- E njëjta vlerë është e përcaktuar edhe ne Planin Përfundimtar te Prokurimit, për vitin fiskal 2023, te Autoritetit tuaj Kontraktues dhe te Publikuar. *(te cilin mund ta gjeni te bashkangjitur)*

Neni 13, paragrafi 1, i rregullores 001/2022, se KRPP-se, përcakton qe: ***"Në parashikimin vlerës së kontratës AK është përgjegjës për krahasimin e çmimeve të tregut, çmimeve të kontratave paraprake kur ato ekzistojnë, etj, me analizë të kostos të specifikimeve relevante teknike të mallrave, shërbimeve ose punëve për prokurim"***.

AK - MSH, paraprakisht tregjet dhe çmimet për produktet e e lotit 1 dhe 2, i ka te njohura dhe te krahasuara, ku jeni te obliguar te bëni krahasim edhe te kontratave paraprake tani me të konsumuara, çuditërisht, i shmangeni edhe Planifikimit përfundimtar te Prokurimit te vitit 2023.

Neni 16, i LPP-se, Llogaritja e Vlerës se Parashikuar për kontratat për furnizim, paragrafi 1 përcakton:

"Vlera e parashikuar e kontratës së propozuar për furnizim duhet të jetë e barabartë me çmimin përfundimtar që duhet të paguhet nga autoriteti kontraktues për të gjitha produktet, shërbimet dhe objektet e tjera që përfshihen në një kontratë të tillë. Çmimi i parashikuar i produkteve, shërbimeve dhe objekteve është çmimi i parashikuar i tyre në ditën e dërgimit të njoftimit të kontratës lidhur me to. Gjatë përcaktimit të vlerës së parashikuar të një kontrate të propozuar për furnizim, autoriteti kontraktues do t'i përfshijë të gjitha elementet e çmimit përfundimtar që mund të parashikohen në mënyrë të arsyeshme..."

Pra ju si AK - MSH, këtë procedure te prokurimit dhe me vlerën e përcaktuar si te planifikuar dhe te publikuar e keni ndryshe, çuditërisht vetëm për lotet 1 dhe 2, e keni zvogëluar, veprimi si i tillë përveç se është kundërligjore, mund te shkaktoi edhe pasoja publike shëndetësore, prandaj ne edhe tani mendojmë se "lëshimi teknik", do te korrigjohet përmes formularit, korrigjimit te gabimit, sa i përket lotit 1 dhe 2, forme ljo standarde e miratuar nga KRPP dhe obliguese për ju si AK.

Baza ligjore, dhe provat shkresore te prezantuara si me larte tregojne qarte , veprime kundërligjore dhe shkeljen e parimeve te Prokurimit Publik, prandaj ne kërkojmë qe përmes **VENDIMIT**:

- **Të aprovon**i, kërkesën ne tërësi si te bazuar;
- **Të nxjerrni**, njoftim për korrigjim te gabimit dhe te zgjatni afatin për ofertim siç përcaktohet me dispozitat e nenit 53, paragrafi 7, i LPP-se dhe te aplikoni kërkesa dhe kritere relevante dhe proporcionale me objektin e kontratës për te gjitha llotet dhe
- **Të ndryshohet**, vlera e parashikuar për lotet 1 dhe 2, sipas vlerës se parashikuar dhe të publikuar ne Planin Përfundimtar te Prokurimit për vitin fiskal 2023

Pergjigjia e Autoriteteit Kontraktues ne lidhje me pretendimin Ankimore

AK nuk pajtohet me kërkesën tuaj për rishqyrtim te parashtruar për AP, për Lotin 1 dhe 2, duke marre parasysh se sikur për te gjitha produktet farmaceutike qe tenderohen, njëjte edhe për Lot 1 - Interferon Beta 1a 22mcg dhe Lot 2 - Interferon beta 1a 44mcg, Ministria e Shëndetësisë ka përdorur praktiken e njëjtë qe para tenderimit te behet hulumtimi i çmimeve te tregut, me qellim qe vlera e parashikuar për produktet qe tenderohen te jete sa me e sakte dhe ne harmoni me qëllimin e aktivitetit te prokurimit.

Çmimet janë përcaktuar sipas përlogaritjeve te bëra nga komisioni për hulumtimin e tregut, i cili është bazuar ne çmimet e importit, çmimet e rajonit ne linket zyrtare te shteteve, andaj Njësia e Kërkesës ne MSh rekomandon se munde te vazhdohet me aktivitetin e prokurimit.

Shqyrtimi dhe përlogaritja e çmimeve nga komisioni dhe përcaktimi i tyre si "tavan" për këto produkte është objektiv, e njëjta gjë është rikonfirmuar edhe pas kërkesës për rishqyrtim, andaj vlerat e parashikuara mbeten te pandryshuara ne Dosjen e tenderit.

AK-MSh konsideron se ky vendim është ne harmoni me nenin 1 te LPP-se – Qëllimi

1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.
2. Ky ligj ka për qëllim të nxisë krijimin e një kulture institucionale të profesionalizuar të pandikuar nga interesat materiale, të paanshme, etike, në mesin e personave zyrtarë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, duke kërkuar nga personat e tillë që të sjellen duke ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike ndërkaq duke iu përmbajtur rreptësisht procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

1. "PHARMA LEADER" L.L.C.
2. Operatoreve ekonomik te interesuar


Berat Marmullaku
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit